

Pran
14.01.2019

C.nr.986/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Habib Zeqiri, në çështjen juridike sipas padisë së paditësit [REDACTED], të cilin me autorizim e përfaqëson Av. [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizaj - Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED], për çështjen e pagesave përcjellëse dhe jubilarë me datë 04.01.2019 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED], nr. [REDACTED]

II. DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit që paditësit të i'a paguaj shumen në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej 1,120.83 €, dhe një pagave jubilarë bazë në lartësi prej 373.61 € dhe atë shumen e përgjithshme prej 1,494.44 € (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër euro e dyzetë e katër cent) të gjitha këto me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë prej dt.12.10.2018 e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 269 € (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro) të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi me datë 12.10.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurës Drejtoria e Arsimit-Komuna e Ferizajt lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe një page jubilarë.

I autorizuari i paditësit në fjalën e tij ka deklaruar se : mbës në tersi pranë padisë dhe kërkesë padisë së precizuar që kërkesëpadinë të e aprovon në tersi si të bazuar sepse nga provat të cilat janë administruara u vërtetua baza juridike e kërkesë padisë si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurës ka deklaruar se: fillimisht bëjë përmirësimin e shkresës zyrtare të Drejtorisë së Arsimit të dt. 27.11.2017 që të jetë 27.11.2018 dhe ka shtuar se mbetet në tërësi në përgjigjen në padi duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë si dhe precizimin e padisë së paditësi, si të pabazuar në ligj. Gjithashtu ka theksuar se Drejtoria Komunale e Arsimit nuk është nënshkruese kolektive nr.24 e datës 18.04.2017, e që punëdhënësi me punëmarrësin nuk kanë hyrë në marrëdhënie Juridiko-Kontraktuale. Ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet e pa bazuar.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave dhe atë: Kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës me nr. të protokollit 05 e dt. 01.09.2015; Vërtetimi i lëshuar nga shkolla fillore e mesme e lartë "Faik Konica"-Ferizaj me nr. të protokollit 170 i dt. 30.4.2018; listat e pagës për tre muajt e fundit të paditësit të dt. 24.04.2017, 27.02.2018 dhe 27.03.2018; librezat e punës me nr. serik 150746; Vendimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i dt. 06.06.2018; shkresa-shënimi zyrtar i Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Ferizajt i dt. 27.11.2017; vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës së moshës së pensionimit me nr. 1538 i dt. 05.1.2018 lëshuar nga Drejtoria e Arsimit-Komuna Ferizaj.

Gjykata, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat veç e veç, dhe të ndërlidhura e varura reciprokisht në mes veti, si tërësi nga bindja e lire e krijuar në bazë të gjendjes së fakteve dhe provave të çështjes, këtë në kuptim të nenit 8 të LPK- së, ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konsideroj se në bazë të provave të administruara nuk ishte kontestuese në mesë palëve se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura dhe i njëjti ka punuar deri në momentin e pensionimit me datë 14.04.2018, po ashtu i njëjti ka përvojën e punës mbi 30 vite dhe se me arritjen e moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës–Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për

punëmarrësin – Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve më datë 18.04.2017.

Në pjesën hyrëse, respektivisht, në nenin 1 të Kontratës Kolektive, është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga Kontrata Kolektive, e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë, pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë, për faktin se, me rastin e daljes së tij në pension, kontrata kolektive ka qenë në fuqi, e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 35 par. 8 pika 8.3 dhe 9 pika 9.1 të Kontratës Kolektive, për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. Punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension, paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 8 pika 8.3 e ka pasur për obligim të i'a paguaj një pagë bazë për 30 vite të përvojës së punës dhe sipas nenit 9 pika 9.1 t'ia paguajë tri paga përcjellëse e paditura ka qenë e obliguar që paditësit s që të bëjë pagesën, pa pasur nevojë as për t'i paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Me leximin e listave të pagave për muajt Shkurt, Mars dhe Prill të vitit 2018 është konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar pagës në shumë të përgjithshme prej 1120.83 € dhe atë, për muajin Shkurt pagën mujore prej 373.61 €, për muajin Mars pagën mujore prej 373.61 €, dhe për muajin Prill pagën mujore prej 373.61 €.

Sa i përket pretendimit të paditurit se Drejtoria e Arsimit nuk është palë nënshkruese e Kontratës Kolektive, për gjykatën një pretendim i tillë është i pa bazuar, sepse Kontrata Kolektive është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) respektivisht neni 2 paragrafi 1 nëpërparafili 1 përcakton, mes tjerash: “ *Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjithë institucionet publike.....në mbarë territorin e Republikës së Kosovës* ”.

Përfundimisht, gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata me rastin e aprovimit të lartësisë së kërkesëpadiës, paditësit i'a ka njohur kamatën ligjore prej 8% prej ditës së paraqitjes së padijes 12.10.2018 e deri në pagesën përfundimtare konform nenit 382 të LMD-së.

Në bazë të nenit 452 par.1 të LPK-së e paditura është obliguar t'i paguaj paditësit shpenzimet e procedurës dhe atë taksën gjyqësore për padi në shumë prej 30 €, për përpilim të padisë shumen prej 104 €, për një përfaqësim të avokatit në seancë shumen prej 135 €, bazuar në nenin 10.1 të UA nr.2/2008 të KGJK-së, për unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.986/18 më datë 04.01.2019

Gjyqtari,

Habib Zeqiri



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 25 / 01 20 19
Dana

